



BQK publikoi statistikat për sektorin e jashtëm për tremujorin e katërt të vitit 2014 dhe për muajin janar 2015

Kumtesë për shtyp
1 prill 2015

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës publikoi statistikat e sektorit të jashtëm me të dhënat për tremujorin e katërt 2014 dhe për muajin janar 2015. Të dhënat janë publikuar në kuadër të Serive Kohore në faqen e internetit të BQK-së sipas kalendarit paraprak të publikimeve. Statistikat e sektorit të jashtëm përfshijnë statistikat e bilancit të pagesave, pozicionit të investimeve ndërkombëtare, statistikat e borxhit të jashtëm të Kosovës, remitencat, investimet e huaja direkte, investimet në letra me vlerë jashtë vendi, etj.

BQK-ja ka bërë avancim në përpilimin dhe publikimin e statistikave të bilancit të pagesave, duke rritur periodicitetin nga tremujor në mujor dhe shkurtuar afatin e publikimit nga $t + 90$ ditë në $t + 60$ ditë. Paraprakisht është avancuar sistemi i sigurimit dhe përpunimit të të dhënave të cilat tani janë adekuate për të përmbushur afatet kohore ($t+60$) dhe periodicitetin në bazë mujore. Indikatorë të rëndësishëm ekonomik të Kosovës të cilët janë nën-komponentë të bilancit të pagesave, si bilanci tregtar, remitencat, investimet e huja direkte, asetet rezervë, etj., tani e tutje do të publikohen në baza mujore me një afat 60 ditë pas përfundimit të muajit referues. Për më shumë, janë përgatitur dhe publikuar edhe seritë kohore për dymbëdhjetë muajt e vitit të kaluar për të siguruar një analizë dhe krahasueshmëri të trendeve të fundit në bilancin e pagesave të Kosovës.

Të dhënat e publikuara janë në përputhje me standardet statistikore ndërkombëtare dhe ofrojnë një shkallë të lartë të krahasueshmërisë me ato të vendeve të tjera. Këto informata njëkohësisht publikohen edhe në FMN në kuadër të publikimit “Statistikat Financiare Ndërkombëtare” (anglisht: International Financial Statistics – IFS) dhe në Bankë Botërore në kuadër të publikimit “Statistikave Tremujore të Borxhit të Jashtëm” (anglisht: Quarterly External Debt Statistics – QEDS).


Më poshtë është dhënë një pasqyrë e përmbledhur, që karakterizon statistikat e sektorit të jashtëm për tremujorin e katërt 2014. Në fund është paraqitur edhe një shtojcë statistikore lidhur me komponentët kryesorë të statistikave të sektorit të jashtëm. Për më shumë klikoni [këtu](#).

SEKTORI I JASHTËM

Bilanci i pagesave të Kosovës

Në tremujorin e katërt të vitit 2014 deficitin e llogarisë rrjedhëse ishte 151.2 milionë euro duke shënuar rritje prej 38.9 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2013. Përveç llogarisë së mallrave, e cila në vazhdimësi ndikon në rritjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse, të tre komponentët e tjerë të llogarisë rrjedhëse kanë ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e këtij deficitit. Deficitin e llogarisë së mallrave në tremujorin e katërt 2014 ishte 537.2 milionë dhe ka pasur përafërsisht një nivel të njëjtë me tremujorin e katërt 2013. Llogaria e shërbimeve vazhdon të shënojë bilanc pozitiv, vlera e së cilës në tremujorin e katërt 2014 arriti 59 milionë euro (47.7 milionë euro ishte në TM4 2013). Të ardhurat parësore në tremujorin e katërt 2014 shënuan vlerën 23.8 milionë euro, e cila është për 20.8 milionë euro më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Llogaria e të ardhurave dytësore mbetet kontribuuesi kryesor në zbutjen e deficitit të llogarisë rrjedhëse. Megjithatë, ndikimi pozitiv i llogarisë së të ardhurave dytësore në uljen e deficitit të llogarisë rrjedhëse gjatë këtij tremujori ka qenë më i vogël krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kjo ka qenë arsyeja kryesore që deficitin e llogarisë rrjedhëse në këtë tremujor ka shënuar rritje. Në tremujorin e katërt 2014, llogaria e të ardhurave dytësore shënoi vlerën 303.9 milion euro (332.9 milionë ishte në tremujorin e katërt 2013). Remitenat në Kosovë në tremujorin e katërt 2014 ishin 188.1 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 13.1 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Figura 1. Deficitin e llogarisë rrjedhëse, në milion euro




Bilanci i investimeve të huaja direkte (IHD) në Kosovë në tremujorin e katërt të vitit 2014 ka arritur vlerën 29.5 milionë euro dhe ishte për 51 përqind më e ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Niveli më i ulët i IHD-ve në këtë tremujor krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak erdhi si rezultat i tërheqjes së kapitalit në formë të superdividentës dhe kthimit më të lartë

të kredive ndaj kompanive investuese. Pozicioni i investimeve në letra me vlerë jashtë vendi, pa përfshirë letrat me vlerë në kuadër të aseteve rezervë, gjatë këtij tremujori është zvogëluar për 99.4 milionë euro. Gjithashtu edhe asetet rezervë janë zvogëluar në tremujorin e katërt për 80.8 milionë euro.

Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

Kosova vazhdon të regjistrojë bilanc pozitiv të pozicionit të investimeve ndërkombëtare (PIN) i cili në fund të tremujorit të katërt të vitit 2014 arriti vlerën prej 299.6 milionë euro (380.4 milionë ishte në fund të tremujorit paraprak). Asetet e jashtme kanë shënuar rënie prej 25.5 milionë nga tremujori paraprak dhe shënuan vlerën 4.29 miliardë euro. Kontribuesit kryesor në rënien e aseteve të jashtme ishin kategoria e investimeve portfolio (e cila ishte më e ulët për 79 milionë euro) dhe kategoria e *aseteve rezervë* (e cila kishte një rënie prej 80 milionë euro). Në anën tjetër kategoria e investimeve të tjera kontribuoi pozitivisht në lehtësimin e rënies së aseteve të jashtme (në vlerë prej 123.3 milionë euro). Detyrimet ndërkombëtare kanë shënuar rritje në vlerë prej 55.2 milionë euro krahasuar me tremujorin paraprak. Vlera e detyrimeve në fund të tremujorit të katërt të vitit 2014 ishte 3.97 miliardë euro. Rritjes së detyrimeve të huaja më së shumti i ka kontribuar kategoria e investimeve të huaja direkte (rreth 36.1 milionë euro) dhe investimeve tjera (rreth 19.1 milionë euro).


Figura 2. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare, gjendja në fund të periudhës në miliardë euro



Borxhi i jashtëm i Kosovës

Borxhi i jashtëm bruto i Kosovës, i cili përfshin borxhin publik dhe borxhin privat, në fund të dhjetorit 2014 shënoi vlerën 1.73 miliardë euro. Borxhi publik ka një pjesëmarrje të ulët në gjithsej borxhin e jashtëm (rreth 23 përqind), gjendja e të cilit në fund të dhjetorit ishte 392.8 milionë euro. Pjesa më e madhe e borxhit publik përbëhet nga borxhi i jashtëm i Qeverisë, i cili në fund të dhjetorit 2014 ishte 326.4 milionë euro.

Figura 3. Borxhi i jashtëm bruto, gjendja në fund të periudhës në miliardë euro¹



Borxhi i sektorit privat në fund të dhjetorit 2014 shënoi vlerën prej 1.34 miliardë euro. Pjesa më e madhe e borxhit privat është në formë të kredive ndërmjet kompanive, që janë në relacion të investimeve direkte (719.9 milionë euro), pasuar nga borxhi i sektorëve tjerë të ekonomisë (390.1 milionë euro) dhe huamarrjet e bankave komerciale (229.0 milionë euro). Në kuadër të sektorëve tjerë bëjnë pjesë korporatat financiare jobankare, korporatat jofinanciare, ekonomitë familjare dhe organizatat joqeveritare. Kreditë tregtare dominojnë në kuadër të sektorëve të tjerë, vlera e të cilave në fund të tremujorit të katërt 2014 arriti në 158.5 milionë euro.

¹ Në kuadër të borxhit publik është përfshirë edhe alokimi i SDR-ve nga FMN-ja, konform standardeve ndërkombëtare.

Shtojca statistikore

Tabela 1. Bilanci i pagesave

(Në milionë euro)

Përshkrimi	2012	2013	2014	2013				2014			
				T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
Llogaria rrjedhëse	-380.2	-339.4	-441.0	-13.4	-117.5	-99.7	-108.8	-37.8	-160.2	-91.8	-151.2
Mallrat	-2,050.1	-1,995.6	-2,051.5	-390.7	-518.6	-551.9	-534.3	-391.5	-540.4	-582.4	-537.2
Eksporti (f.o.b.)	281.9	298.5	320.8	68.5	80.8	72.0	70.2	65.8	73.9	95.7	85.3
Importi (f.o.b.)	2,332.0	2,287.0	2,372.3	459.2	599.4	623.9	604.5	457.3	614.4	678.1	622.5
Shërbimet	323.8	312.2	336.1	60.6	79.7	124.1	47.7	62.7	76.5	137.9	59.0
Eksporti	641.4	632.5	770.6	105.6	148.3	240.4	133.5	126.6	165.1	287.8	191.1
Importi	317.6	320.3	434.5	45.1	68.6	116.3	85.7	63.8	88.6	149.9	132.1
Të ardhurat parësore	153.6	121.5	106.3	42.4	32.5	2.1	44.6	31.4	31.4	19.8	23.8
Kredi	230.0	227.5	214.5	57.3	55.4	55.3	59.6	49.6	53.2	58.5	53.2
Debi	76.4	106.0	108.1	14.9	22.9	53.3	15.0	18.2	21.8	38.7	29.5
Të ardhurat dytësore	1,192.5	1,222.4	1,168.1	274.3	288.9	326.0	333.2	259.7	272.3	332.9	303.3
Kredi	1,296.4	1,304.0	1,266.5	301.3	316.3	353.6	360.5	285.8	298.6	361.0	321.0
prej të cilave: Remitancat	605.1	620.8	693.8	127.8	144.6	182.2	166.2	130.8	160.5	214.4	188.1
Debi	103.9	81.6	98.4	27.0	27.4	27.6	27.4	26.2	26.3	28.2	17.8
Llogaria kapitale	12.9	34.7	21.2	10.6	3.1	9.7	11.4	3.4	-2.6	4.6	15.8
Kredit	31.6	41.0	33.5	10.1	7.0	7.3	16.6	7.2	0.0	7.4	18.9
Debit	18.7	6.3	12.3	0.5	3.9	-2.4	5.2	3.8	2.6	2.8	3.1
Llogaria financiare	-141.0	-132.2	-145.1	10.1	-138.1	58.1	-62.2	33.4	-115.8	44.8	-107.5
Investimet direkte	-213.3	-250.2	-123.9	-57.3	-83.8	-56.8	-52.4	-37.5	-0.2	-67.2	-19.1
Asetet	15.8	30.0	27.3	3.1	5.0	13.8	8.2	5.2	-3.8	15.5	10.4
Detyrimet	229.1	280.2	151.3	60.3	88.7	70.6	60.6	42.7	-3.6	82.6	29.5
Investimet në letrat me vlerë	185.7	139.3	13.3	53.5	81.7	91.8	-87.7	50.2	3.2	59.3	-99.4
Asetet	185.7	139.3	13.3	53.5	81.7	91.8	-87.7	50.2	3.2	59.3	-99.4
Detyrimet											
Investimet e tjera	-374.9	14.4	22.6	20.1	-150.6	-46.2	191.1	26.8	-97.1	1.1	91.8
Asetet	-146.3	83.5	106.8	-39.1	-106.1	33.1	195.6	8.7	-53.5	42.6	108.9
Detyrimet	228.5	69.2	84.2	-59.2	44.5	79.3	4.5	-18.1	43.6	41.6	17.1
Asetet rezervë	261.4	-35.7	-57.0	-6.3	14.6	69.3	-113.3	-6.2	-21.7	51.7	-80.8
Gabimet dhe harresat	226.2	172.5	274.7	12.9	-23.8	148.1	35.3	67.7	47.0	132.1	27.9

Tabela 2. Pozicioni i investimeve ndërkombëtare

(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2012			2013				2014			
	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
PIN Neto	319.3	237.7	248.8	416.8	276.2	414.9	363.7	401.9	328.4	380.4	299.6
Asetet	3,351.7	3,634.0	3,705.1	3,857.2	3,846.9	4,076.4	4,102.6	4,172.4	4,117.8	4,302.2	4,276.6
Investimet direkte	110.6	113.9	117.9	120.9	125.2	139.6	147.5	152.7	148.9	164.4	174.6
Investimet portfolio	814.5	998.7	986.6	1073.1	1138.1	1253.9	1192.6	1252.4	1280.8	1354.1	1274.7
Në kapital dhe në aksione në fonde investive	598.7	621.9	666.3	734.3	777.6	816.6	650.8	660.4	752.4	967.4	1,024.4
Në letra me vlerë të borxhit	215.9	376.8	320.3	338.8	360.5	437.3	541.7	592.0	528.4	386.7	250.3
Derivatvët financiarë											
Investimet tjera	1,826.1	1,715.6	1,760.6	1,829.8	1,737.3	1,768.9	1,963.2	1,974.3	1,916.2	1,958.2	2,081.5
Ekuitete të tjetër	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Paraja e gatshme & depozita	1,762.0	1,633.3	1,673.9	1,721.3	1,631.8	1,655.9	1,833.6	1,833.7	1,778.5	1,855.1	2,006.2
Kreditë	58.2	79.1	81.3	94.4	84.5	96.6	112.0	124.0	119.5	86.7	61.4
Kreditë tregtare dhe avanset	1.0	1.0	1.2	11.0	16.8	13.9	13.7	12.1	12.8	14.6	11.2
Llogaritë e tjera të pranueshme	4.9	2.1	4.3	3.1	4.3	2.5	4.0	4.5	5.4	1.7	2.7
Asetet rezervë	600.9	805.8	840.0	833.4	846.2	913.9	799.3	793.1	771.8	825.5	745.9
Detyrimet	3,032.4	3,396.3	3,456.3	3,440.4	3,570.7	3,661.5	3,738.8	3,770.5	3,789.4	3,921.8	3,977.0
Investimet direkte	2,385.0	2,471.5	2,524.3	2,582.4	2,669.4	2,739.9	2,816.4	2,859.7	2,838.1	2,923.0	2,959.1
Investimet portfolio	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Në kapital dhe në aksione në fonde investive	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Në letra me vlerë të borxhit	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Derivatvët financiarë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	647.4	924.8	931.9	858.0	901.3	921.6	922.4	910.8	951.3	998.8	1,017.9
Ekuitete tjera	0.7	0.7	0.5	1.8	0.7	0.8	0.7	0.8	0.8	0.8	0.9
Paraja e gatshme dhe depozitat	107.7	115.4	120.9	130.6	110.6	129.2	123.8	136.9	126.6	145.9	143.6
Kreditë	472.2	515.5	541.3	537.4	564.9	561.6	579.6	585.1	601.7	603.8	645.9
Kreditë tregtare dhe avanset	167.3	219.6	199.8	119.4	156.5	162.9	154.3	121.1	155.5	180.1	158.5
Të drejtat speciale të tërheqjes – DST	66.7	66.0	64.6	64.8	63.7	62.9	61.9	62.1	62.7	65.2	66.1

Tabela 3. Borxhi i jashtëm

(Në milionë euro: Gjendja në fund të periudhës)

Përshkrimi	2012			2013				2014			
	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4	T1	T2	T3	T4
Borxhi Publik dhe Borxhi Publik i Garantuar	321.0	361.2	401.4	398.0	394.8	387.8	383.9	379.7	381.8	383.4	392.8
Qeveria e Përgjithshme	253.5	294.2	336.5	332.8	331.1	324.6	321.8	317.5	318.9	318.1	326.4
Afatshkurtër	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Afatgjatë	253.5	294.2	336.5	332.8	331.1	324.6	321.8	317.6	319.0	318.1	326.4
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës	67.5	66.9	65.0	65.1	63.8	63.2	62.1	62.2	62.9	65.4	66.3
Afatshkurtër	0.7	0.9	0.4	0.3	0.1	0.3	0.3	0.1	0.2	0.1	0.3
Afatgjatë	66.7	66.0	64.6	64.8	63.7	62.9	61.9	62.1	62.7	65.2	66.1
Borxhi i Sektorit Privat i Pagarantuar	915.9	1,172.1	1,115.9	1,054.9	1,146.1	1,197.0	1,224.3	1,217.0	1,266.4	1,325.6	1,344.2
Korporata Depozituese, me përjashtim të Bankës Qendrore	176.0	184.1	175.6	185.8	184.3	206.8	208.1	225.2	229.3	229.0	234.2
Afatshkurtër	176.0	184.1	175.6	185.8	184.3	206.8	208.1	225.2	229.3	229.0	234.2
Afatgjatë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Sektorët tjerë	149.8	378.9	354.4	272.5	321.4	326.2	329.7	305.1	339.4	385.6	390.1
Afatshkurtër	110.9	340.6	321.0	238.3	277.1	278.4	281.1	249.1	283.4	314.3	294.8
Afatgjatë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investimet Direkte: Kreditimi ndërmjet kompanive	38.8	38.3	33.5	34.2	44.3	47.7	48.5	56.0	55.9	71.2	95.3
kompanive	590.1	609.1	585.9	596.7	640.4	664.0	686.5	686.7	697.8	711.1	719.9
Gjithsej Borxhi i Jashtëm Bruto	1,236.8	1,533.2	1,517.3	1,452.9	1,541.0	1,584.8	1,608.2	1,596.8	1,648.3	1,709.0	1,737.0